



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*



## PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **21.04.2020**, me fillim në ora **10.00**.  
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë të pranishmit e tjerë.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

## REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i Raportit financiar janar-mars 2020,**
3. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2018-2019 në vitin 2020,**
4. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave juridik P-02279/0,02280/0 dhe 02281/0,**
5. **Të ndryshme.**

**Kryesuesi** – E vë në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar** – A ka dikush diçka rreth procesverbalit?

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, nënkryetarin, kolegë këshilltarë, drejtorët dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë kam vetëm një plotësim në faqen 2, ka pjesa e poshtme në diskutimin tim që kam thënë edhe plani i veprimit për zgjedhjet e problemeve ndërsa këtu në procesverbal është e shkruar përzgjidhet pra duhet të jetë për zgjedhje të problemeve, pra është ajo shtylla e tretë e pikës në fjalë që kemi diskutuar, pra jo të përzgjidhet por për zgjedhje të problemeve pasi që e ka një kuptim krejt ndryshe pra veprimi i përzgjedhur dhe duhet të jetë i zgjedhur. Po ashtu në faqe 3, te rreshti i parë unë e kam cekur që Drejtori i Arsimit kurse në procesverbal shkruan i Shëndetësisë që ndoshta edhe unë kam gabuar mirëpo është fjala për Drejtorinë e Arsimit dhe jo të Shëndetësisë. Faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë z. Cena, atëherë pasi që nuk ka tjetër dikush, e qesim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

**2. Shqyrtimi i Raportit Financiar janar- mars 2020.**

**Afrim Limani** – I nderuari Kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së dhe ju gjithë të pranishëm. Për kundër aprovimit të vonshëm të buxhetit në nivel qendrorë, ne si organizatë buxhetore kemi arritur që të bëjmë një shpenzim të buxhetit në një masë prej 2.666.000 në të gjitha kategoritë, sepse buxheti fillimisht se nuk është aprovuar, pasi buxheti është alokuar sipas ligjit të Financave Publike dhe përgjegjësitë pra në dy muajt u nda 1/3 e buxhetit kurse në muajin e tretë është bërë alokimi i buxhetit në shumën prej 6.300.000 dhe në brenda kësaj periudhe kemi arrite që të bëjmë një shpenzim të buxhetit në të gjitha kategoritë në shumën prej 2.600.000. Për kundër asaj edhe situatës së krijuar edhe procesi i të hyrave ka vazhduar mirë deri me datën

15 mars të hyrat kanë qenë në total prej 244.000 që përafërsisht ka qenë i njëjtë por me një diferencë të vogël negative me vitin e kaluar. Mirëpo pas datës 15 mars dhe deri më tani ju informoj se kemi rënie të dukshme të të hyrave vetanake, shpresoj që shumë shpejtë të tejkalojmë këtë situatë dhe t'i kthehemi normalitetit edhe të kemi inkasim të mirë edhe të rregullt të të hyrave vetanake.

Raporti tre mujor përkundër herëve tjera, ka një formë pra dizajn pak më ndryshe dhe ne si Drejtori e Financave jemi munduar që këtë raport ta thjeshtësojmë më tepër edhe të gjitha aktivitetet dhe shërbimet të jenë sa më të përafërta me një faqe apo eventualisht në dy faqe dhe nëse ju keni ndonjë koment, vërejtje apo sugjerim e mirëpres këtë drejtim. Në faqe numër 3, e kemi të koncentruara të gjitha të hyrat do të thotë brenda raportit të 3 muajve, të hyrat kanë qenë 244,000 euro, periudha e njëjtë e vitit të kaluar ka qenë 246,000 euro pra kemi një diferencë negative prej 2,445 euro ndërsa në total bashkë me gjobat e gjykatave dhe trafikut sepse gjobat e gjykatave këtë vit kanë qenë shume më të mira atëherë diferenca është prej 1.867 euro, gjithmonë nuk e kemi edhe një raport akoma të muajit mars të gjobave dhe trafikut dhe besoj edhe kjo diferencë negative kalon në pozitive dhe do të kemi rritje tjetër. Në faqe 4, i kemi të hyrat sipas kategorive ekonomike, në faqe numër 5 kemi të hyrat nga tatimi në pronë ku në total brenda kësaj periudhe të hyrat nga tatimi në prone kanë qenë 92.436 euro me një diferencë negative prej 12.000 euro në raport me vitin e kaluar. Ndërsa në faqe numër 6, kemi shpenzimin e buxhetit sipas kategorive, po ashtu një tabelar me poshtë kemi shpenzimin e buxhetit në raport me alokimin dhe planifikimin e buxhetit, ku shpenzimi i buxhetit siç thash edhe në fillim, kemi një shpenzim prej 2,666,000 euro në të gjitha kategoritë me një përqindje prej 18% në total në raport me planifikimin. Po ashtu kemi edhe shpenzimin e buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve sipas kategorive ekonomike dhe krejt në fund e kemi edhe shpenzimin e buxhetit sipas komunalive. Këtij raporti i mungon raporti i aktiviteteve nga Zyra e Prokurimit sepse brenda kësaj periudhe nuk kemi pasur ndonjë aktivitet edhe normal që nuk e kam parë të arsyeshme edhe me qitë si raporte.

Para se ta mbyllim, unë desha me ju dhanë një sqarim, sigurisht që do të kemi pyetje edhe nga ju, të shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike në kuadër të mallrave dhe shërbimeve te zyra e Kuvendit komunal kemi një shpenzim për dreka zyrtare prej 1,774 euro, sigurisht që edhe ju jeni çudite se ku e kemi bërë ne këtë shpenzime mirëpo desha me ju informua sepse ata të cilët kanë qenë asamblistë edhe me herët, e dinë që në vitin 2014 është nxjerrë një vendim nga ana e Kuvendit për me i pagua shpenzimet e aktiviteteve të shoqatës Eksodi në Xërxe dhe Kuvendi ka marr një vendim të tillë që i paguan këto aktivitete kryesisht janë dreka zyrtare që vlera e tyre do të thotë për një vit e kalon shumë prej 1,000 euro edhe pse këtë vit kemi pasur 1,300 euro. Pra kjo është, unë nuk e di a e kam të drejtën me dhanë një propozim, do ishte mirë këtë vendim me ndryshua, jo që nuk dua të ju ndihmoj atyre por me ju ndihmua eksodit të shoqatës ka edhe forma tjera edhe zakonisht ajo bëhet përmes subvencioneve, edhe ata aplikojnë me thirrje të përgjithshme edhe pse në raport figuron si drekë zyrtare. Pra sikur të bëhet shpenzimi nga kodi i subvencioneve atëherë nuk figuron edhe si shpenzim në dreka zyrtare që kuptohet se kjo ngarkohet edhe kodi i Kuvendit.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume drejtor për sjelljen e këtij raporti, edhe u bo mirë që u sqarua për shkak se kam deashur edhe si pyetje me ta bo, po ashtu edhe kodi 13440 e keni te Kuvendi Komunal 2,300 euro, për këto te shpenzimet e karburanteve është gjithçka në rregull, pastaj kodi 1401 për riparim të makinave mirëpo kjo te drekat zyrtare tani veçse u sqarua dhe tani e tutje e shohim si do të shkon por njëkohësisht edhe mbledhje të Kuvendit duhet me bo të njëjtin sqarim. Faleminderit shumë!

**Florida Bajraktari** – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për te gjithë. Tek paraqitja e shpenzimeve tek kategoria mallrave dhe shërbimeve sipas kodeve tek tabela a, b dhe c, faqe 8,9 dhe 10-të tregojnë se shpenzimet janë shumë më të mëdha në këtë tre mujor krahasuar me periudhën e vitit 2019 p.sh. Administrata në tremujorin e vitit 2019 ka shpenzuar 11,656 euro ndërsa në tremujorin e këtij viti pra 2020 janë trefishuar 31,413 euro, ngjashëm është edhe me disa drejtori tjera dhe është mirë drejtori me na dhanë sqarime për këto shpenzime enorme krahasuar me tremujorin e vitit paraprak. Faleminderit!

**Rasim Fazliu** – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për ju, nënkryetarin, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët dhe gjithë ata që monitorojnë këtë mbledhje. Fillimisht e falënderoj drejtorin për prezantimin e buxhetit për tre mujorin e parë të vitit 2020. Prezantimi ishte mjaft i qartë dhe unë tash do të shkoj me radhë por ndoshta i shoh gjërat pak më ndryshe se sa drejtori, ku në faqe 3, shohim të hyrat e rregullta të realizuara në baza mujore 2019-2020 dhe krahasimi i tyre. Unë mendoj se planifikimi për vitin

2020 ishte 289 210 euro, prej tyre janë realizuar 244,511 euro ose thjesht me thanë 44,698 euro me pak se sa ka qenë e planifikuar. Kështu që duhet me kuptuar se sigurisht se planifikimi për vitin 2019 ka qenë ndryshe më i vogël dhe tani nuk mundemi me thanë se nuk jemi të kënaqur pasi mirë është realizuar por duhet me cekë se karshi planifikimit, realizimi është për këtë shifër që e thash edhe më herët pra më i vogël, sa i përket të hyrave të realizuara në baza mujore. Edhe drejtori e ceku te krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjrobat e trafikut për muajin mars, unë e kam evidentuar ju mungon pra nuk janë te paraqitura fare, pastaj ne faqe 4 krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike për 2020, që është këtu për tu cekur edhe pata dëshirë me pas sqarim rreth kodeve 50016 planifikimi ka qenë për këto 1,168 euro ndërsa realizimi 8,117 euro dhe është tejkalar shumëfish realizimi prej planifikimit d.m.th. në njëfarë mënyrë ndoshta kemi të bëjmë me një planifikim jo të duhur pra jo të mirë, më qenë se është bërë një tejkallim kaq i madh në realizim. Pastaj kodit 50405 planifikimi ka qenë 13,000 ndërsa realizimi është 270 d.m.th. edhe këtu realizimi mjaft i vogël, edhe këtu kemi realizim jo të duhur karshi planifikimit. Pastaj faqe 5, Planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë për vitin 2019-2020 është i paraqitur, edhe këtu planifikimi ka qenë 135,000 i parashikuar ndërsa realizimi është bërë 92,000 euro, unë dua të potencoj që drejtori tha se realizimi është përafërsisht i njëjtë me 2019 veç pak më i vogël por është për të theksuar se varet se sa ka qenë planifikimi për vitin 2019 dhe sa për vitin 2020, ama këtu në planifikim kemi mjaftë diferencë, që 97,191 euro ka qenë në vitin 2019 ndërsa për vitin 2020 është 135,293 euro, edhe pse ka qenë planifikimi më i madh për vitin 2020, realizimi u bo më pak se në vitin 2019, pasi këtu luan rol ngase dhe buxheti u miratua me vonesë pasi edhe rrethanat sivjet ishin pak me ndryshe, tash edhe rasti i Pandemisë që u paraqit edhe po shpresoj të dalim mirë në fund. Pastaj faqe 6, te shpenzimi i buxhetit unë kisha thënë se prapë vlen, pasi buxheti nuk është i shpenzuar ashtu si duhet, nuk e di arsye pse nuk ka pasur mundësi por në qoftë se shkojmë te shpenzimet kapitale, që i kemi 3,905,770 euro, i kemi të shpenzuara vetëm 574,010 euro, pra edhe këtu mund të themi se nuk është shpenzimi i duhur i buxhetit pasi është mjaftë i vogël dhe nëse shkojmë në mënyrë proporcionale e ndajmë vitin në katër periudha me nga tre muaj që i bien 12 muaj, atëherë kjo shumë 574,000 nuk mundet me u realizua as 2 milion euro. Por unë besoj që në të ardhmen kanë me tentua edhe me rregullua këtë, kështu që me dal te realizimi i buxhetit mirë por për momentin ne po e analizojmë vetëm për këtë 3 mujorë, qe mund të konstatojmë se buxheti nuk u shpenzua në kapitale ashtu siç duhet edhe sa duhet edhe pse kemi pasur alokimin prej mbi 1.700.000 euro. Dhe në fund, që foli edhe Florida me herët ku tha se ka shpenzime më të mëdha 2020, ku sigurisht edhe drejtori do të na jep sqarimet se pse këto ndryshime kaq të mëdha janë nga viti në vit pra nga 2019 në 2020, që më të vërtete është për tu befasuar ku ka shumë shpenzime në këtë kategori për mallra dhe shërbime, e drejtori sigurisht që na jep sqarimet e duhura në bazë të pyetjes që ka bërë Florida. Faleminderit shumë!

**Fahrie Lushi** – Faleminderit Kryesues, te nderuar kolegë këshilltarë dhe ju gjithë të pranishëm. Po ashtu edhe unë pajtohem me parafolësit, sikur me atë mënyrën që e arsyetuan periudhën në të cilën kalon vendi ynë brenda kësaj ngjarje e cila filloj në periudhën 13 mars e deri tani. Te shpenzimet siç e përmendi edhe parafolësja Florida të cilën gjë do e theksoja edhe unë, ne po ashtu e presim shpjegimin nga drejtori, mirëpo ajo të cilën mua më ka bërë përshtypje edhe është realizua, pra është 50214 participimet nga qytetarët, realizimi në vitin 2019. Unë dua të di se cila është arsyeja se nuk është vendosë këtu, ajo shifër e participimit nga ana e qytetarëve e të cilën e dimë mjaft mirë që është realizuar sepse ne kemi pasur participim nga qytetarët për vitin 2019, të cilat edhe vet Kryetari i ka përmend për disa herë me radhë, pra është faqe 4, kodit 50214 participimet nga qytetarët dhe përmendet këtu saktësisht, realizimi 2019 dhe po ashtu të planifikuara për vitin 2020 nuk ka fare dhe po ashtu edhe realizim e dimë se është një periudhë fillestare e tyre mirëpo unë kërkoj një sqarim për vitin 2019, se pse nuk figuron këtu apo ndoshta është edhe gabim teknik mirëpo do të ishte mirë ta përmendim edhe ta cekim këtu, sepse është diçka që i arsyetojmë qytetarët tanë që kanë participuar. Faleminderit!

**Fehmi Cena** – Faleminderit Kryesues, e falënderoj edhe unë drejtorin e Financave për paraqitjen e raportit financiar për 3 mujorin e parë vitit 2020, mendoj se është një raport i qartë dhe gjithëpërfshirës. Unë kam disa vërejtje rreth të dhënave në këtë raport, ne faqe 3 te tabela e të hyrat të planifikuara dhe të realizuara. Nga ajo që është planifikuar dhe që ka kaluar nëpër Kuvend, nga 1.156.841 euro, për këtë 3 mujorë janë realizuar 244.511 euro, që do të thotë në përqindje është 21%, e që do të duhej të ishte se paku 25% që të

realizohet plotësisht. Ndërkohe poshtë kësaj e kam një vërejtje pse është një gabim teknik, në këtë tabelë të hyrat e realizuara 2018/2019, e që duhet me qenë 2019/2020 pasi viti 2018 nuk figuron aty. Te tabela 1.2, të hyrat e rregullta të realizuara në baza mujore gjithashtu, nëse shikojmë planifikimin për këtë 3 mujorë dhe ajo çka është realizuar pra është diku 84.5% pra nuk është realizuar ajo që është pritur se paku, megjithëse ju e shpjeguat se është shkaktar, dhe nëse më pyesni pse, pasi ju veç e thatë se shkaktar është gjendja e epidemisë. Mirëpo mua po më intereson tash tek të hyrat, së kur të bisedojmë tash më vonë edhe te të hyrat nga tatimi në pronë edhe aty ka ngecje, po mendoj që në këtë situatë është duke punuar ky shërbim, të hyrat nga tatimi në pronë dhe nëse është duke punuar megjithatë duhet Komuna të shikojë që ai shërbim të punoj si duhet dhe të apelohej te qytetaret, megjithatë kjo vijë e arkëtimit të hyrave duhet të vazhdoj sepse ajo është elementi kryesor i punës së qeverisë lokale dhe është indikator sipas së cilës ne e vlerësojmë edhe performancën e komunës. Te të hyrat nga gjobat, pra gjobat në trafik kanë një rritje pasi shihet një rritje shumë më e mirë ndërsa gjobat në gjykatë kanë një rënie megjithëse kjo nuk është edhe relevante sepse ne e dimë se nga viti 2020 këto të hyrat shkojnë në nivel qendror. Në faqe 4, krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike, kam disa ndërhyrje këtu, tatimin në pronë që ka një rënie pasi veç e përmenda, pastaj tek kodi 50013 taksa për certifikata të lindjes, nëse shikojmë planifikimin 72,500 euro të hyrat janë vetëm 7,652 euro, po mendoj a është kjo një gabim në planifikim për certifikatat e lindjes si ka menduar shërbimi i veçantë, a do të rritet aq shumë nataliteti apo pse kjo hyrje kaq e vogël. Po ashtu kodi 50405 shfrytëzimi i pronës publike, edhe këtu dallimi është shumë i madh pra planifikimi 13,000 kurse të hyrat 2,700, si mendoni me arrit realizimin që e keni planifikuar. Po ashtu edhe te kodi 50503 inspektimi i respektimit i planit urbanistik pra ju fare nuk keni planifikuar ndërsa të hyra keni afër 4,000 euro pra edhe për këtë kisha dashur një sqarim. Në faqe 5, tatimi në pronë pra ajo që është planifikuar për këtë 3 mujor 135,000 kurse janë arkëtuar vetëm 92,000 e që në përqindje i bie 68% keni arkëtuar në planifikimin për këtë 3 mujor. Pra vlen ajo që thash edhe më herët, të shikohet që në këtë drejtim të punohet sigurisht më shumë. Në faqe 6, shpenzimet sipas kategorive ekonomike, parafolësi delegati Rasimi foli gjithashtu dhe unë veç kisha me potencuar gjithashtu edhe tek pagat dhe mëditjet, po më intereson shpenzimet për këtë 3 mujor janë 21.36%. E dimë se kjo kategori ekonomike është fikse edhe është planifikuar për aq sa ka punëtorë dhe sa është menduar me u shpenzuar, pra më pak është shpenzuar dhe kemi mbetje të të hyrave nga kjo kategori buxhetore. Te mallrat dhe shërbimet në përqindje vetëm 12.79% është bërë shpenzimi por nëse shikojmë te tabela edhe sipas drejtorive edhe sipas kodeve kemi dyfishin e shpenzimeve në këtë kategori ndërsa këtu figuron vetëm 12.79%. Po ashtu brengosëse është edhe te shpenzimet kapitale vetëm 14.7% që mendoj se është pak, ku dihet se puna ne investimet kapitale duhet të jetë në mënyrë periodike e njëjtë dhe të mos mbetet pastaj në fund të vitit me pas probleme më shumë edhe me Zyrën e Prokurimit edhe me realizimin e projekteve edhe me pagesa. Te mallrat dhe shërbimet sipas programeve edhe kodeve, për dreka zyrtare megjithëse ajo u sqarua nga ana e drejtorit edhe unë mendoj që në mbledhjen e ardhshme, Kuvendi Komunal duhet me marr një vendim sigurisht a do të vazhdon kështu apo duhet me kalua kjo me një pozicion tjetër. Kaq kisha unë me vërejtjet e mia, mendoj që në mbledhjen ardhshme të Kuvendit Komunal do të ketë një debate pak më të plotë nga të gjithë të pranishmit.

**Afrim Limani** – Faleminderit për pyetjet, për pyetjen nga Florida, se pse ka një shpenzim më të madhe të shpenzimit të buxhetit nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në raport me vitin e kaluar. E vërtetë është se kemi një shpenzim më të madh të buxhetit mirëpo qëllimi edhe esenca është se ne duhet me shpenzuar sa ma shumë këtë buxhet. Sepse çdo buxhet është i planifikuar edhe brenda një viti fiskal ne duhet me shpenzuar atë buxhet në mënyrë që nëse nuk shpenzohet, mbetja shkon në suficit, kështu që trendi i shpenzimit të buxhetit në këtë kategori, e thash edhe në fillim përkundër situatës, unë e konsideroj se është i mirë edhe jam i kënaqur. Tash pse është bërë më shumë shpenzimi i buxhetit sinqerisht ju them se të gjitha faturat të cilat janë tubuar gjatë muajit nëntor dhe dhjetor, ku dihet se atëherë nuk kemi mundësi me i ekzekutuar buxhetin pra faturat e muajit nëntor, dhjetor, janar dhe shkurt ne i kemi ekzekutuar të gjitha, do të thotë se sot nuk e kemi ndonjë borxh nga operatorët e ndryshëm pra është fatura në pritje nga kjo kategori. Pra kjo është edhe arsyeja e shpenzimit të buxhetit për shkak edhe të situatës, e kemi kryer edhe ne pak më shpejt edhe në mënyrë që operatorët të kenë edhe mjete të mjaftueshme. Disa fatura na kanë ardhur pas mbylljes së vitit fiskal, kjo është arsyeja sepse faturat nuk i kemi pasur por ka edhe në ndonjë kategori tjetër që kanë ardhur e

ndoshta nuk kemi pasur buxhet sepse i kemi shpenzuar më herët, pra kjo është arsyeja por në raportet tjera p.sh. në raportin 6 mujor kur e bëjmë prezantimin ndoshta ka me qenë një rënie në raport me vitet e kaluara. Po ashtu mësuesi Rasim i bëri disa pyetje, më shumë u koncentrua te të hyrat pasi realizimi është më i vogël në raport me të hyrat, po ashtu një çështje e shtroj se planifikimi është më i vogël në raport me vitin e kaluar, pasi ne e dimë se gjambat e gjykatave dhe trafikut nuk janë, pasi ato janë një shumë e madhe e mjeteve dhe ato nuk guxojnë të planifikohen nga organizata jonë buxhetore, pasi ato planifikohen nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe kjo krejt e ka prishë këtë balancë. Pastaj te disa kategori, kod në pajtohëm me ty edhe vet kam thënë se është një mos barazi e madhe në raport me planifikim realizimin tek ky kod.

Taksa për certifikata ofiçare – të them të drejtën unë besoj që për Kuvend do ta nxjerr një analizë edhe e shoh vet se pse mirëpo këtë e shohim edhe më vonë në raportin 6 mujor krejt kjo se a do të ndryshon situata apo jo. Po ashtu edhe në tatim pronë kemi një diferencë, këtë pyetje e beri edhe doktori, pra ka diferencë negative në krahasim me vitet e kaluara sepse krejt kjo i ka kontribuar situatës aktuale që është bërë pas datës 15 mars edhe pse trendi i të hyrave me të gjitha këto kategori deri me atë datë ka qenë shumë i mirë edhe besoj që i kishim kaluar edhe vitin 2019. Po ashtu kishte shumë pyetje edhe te shpenzimi i buxhetit, nuk është shpenzuar sa duhet sidomos në investime kapitale kështu që këtë pyetje të gjithë asamblistët e ngritën. Unë e thash se ne e kemi një buxhet të alokuar brenda kësaj periudhe në total prej 6,377,000 euro, do të thotë të ndarë në faza pra në muajin janar, shkurt, mars mirëpo në total është ky buxhet 6,377,000. Vetëm pozicionin e pagave e kemi 3,778,000 euro, ku shpenzimi i këtij buxheti sipas kategorive, në mallra dhe shërbime 203,000 e që unë e konsideroj se është i mirë që e kemi diskutuar edhe më herët pra të gjitha faturat që kanë qenë në pritje i kemi ekzekutuar, pastaj shpenzime komunali 41.000 euro që nuk kemi fatura në pritje pasi i kemi ekzekutuar të gjitha pagesat si mbeturina, rrymë edhe ujë pra ky është shpenzimi real. Pyetjet më shumë u shtruan te shpenzimet kapitale ku 574,000 euro u shpenzuan mirëpo gjatë muajit prill kjo është dyfishuar pra ky shpenzim u bë brenda periudhës sa kemi pasur faturë në pritje, operatorët kanë ofruar faturat dhe ne kemi bërë ekzekutimin e buxhetit do të thotë ato mjete që i kemi pasur në dispozicion, pasi alokimi i tre mujorit të buxhetit është bërë në fillim të muajit prill. Po ashtu edhe Fahria ka shtruar të njëjtën pyetje te shpenzimet më i madh, që po besoj që ajo përgjigje vlen edhe për juve që e arsyetova se pse është bërë shpenzimi i buxhetit në kuadër të mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu e kemi bërë edhe një pyetje tjetër interesant tek të hyrat pra participimi nga qytetarët se pse nuk ka të hyra nga ky kod. Ky kod është ekskluzivisht nëse po supozojmë kemi një projekt të përbashkët komuna dhe qytetarët, pjesa tjetër e inkasimit nga ana e qytetarëve është pikërisht nga ai kod me numër edhe nuk ka pasur inkasim edhe ne në kuadër të këtij kodi nuk guxojmë me planifikuar kurrgjë sepse nuk mundemi me parashikuar atë se a do të ketë, pasi zakonisht që sa vite nuk kemi pasur nga qytetarët.

**Fahrie Lushi** – E kuptoj plotësisht edhe ju falënderoj për sqarimin mirëpo këtu nuk përmendet planifikimi. Këtu është realizimi për vitin 2019 i participimeve të qytetarëve edhe kjo nuk është as kod bashkëpunim kryetar ose komunë por saktësisht është participimet nga qytetarët. Në vitin 2019 ne e dimë se ka pasur participim edhe vetëm nga qytetarët është kodi i emëruar kështu që për këtë arsye nuk është se nuk e kam të qartë mirëpo paqartësia ndoshta është nga ana juaj.

**Afrim Limani** - Ndoshta për ju është paksa e vështirë për shkak të këtyre termave pasi edhe nuk është nga profesioni juaj, ndoshta unë nuk e sqarova mirë kuptohet se krejt këto kode që ekzistojnë janë participim i qytetareve mirëpo ky është kod i veçantë që përdoret në raste të veçanta edhe e kemi emërtuar participimi nga qytetarët me numër 50214, nëse eventualisht paraqitet nevoja në kuadër për një projekt të caktuar që duhet me participua edhe qytetarët atëherë regjistrohen pjesa e pagesës se qytetarët bëhen përmes këtij kodi, edhe këtu nuk guxojmë me planifikuar kurrgjë, edhe nga përvoja e kaluar që sa vite nuk na ka ndodhur asnjëherë p.sh. neve këtë mandat edhe nuk guxojmë me planifikuar edhe planifikimin e bëjmë zero. Pra ky kod përdoret ekskluzivisht për këto punë. Po ashtu doktori i bëri disa pyetje, unë mendoj që te pjesa e të hyrave pajtohëm me ty edhe besoj që në mbledhjen e Kuvendit do t'i korrigjoj edhe ato gabimet teknike pastaj pyetja juaj se pse ka ngecje te të hyrat derisa zyrat e tatimit në pronë funksionojnë mirëpo kur e dimë gjendjen në të cilën jemi, pra për shkak të pandemisë edhe nuk kemi tatim pagues, që zakonisht paguajnë më shumë se 20 apo 50 euro edhe kemi një rënie drastike të hyrave sidomos në kuadër të tatimit në pronë. Po ashtu pyetje, të hyrat e inspektimit të respektimit të planit urbanistik, që dy vite vazhdimisht shtrohet kjo

pyetje nga ana e kuvendarëve edhe ekskluzivisht edhe vet jam marr me këtë, kam shkuar në drejtorinë e Urbanizmit me shefin e IT-së dhe ju kam bllokuar këtë kod, në mënyrë që këto të hyra të regjistrohen në kuadër të lejeve ndërtimore mirëpo ata prapë kanë vazhduar në këtë mandat dhe nuk e di thjesht se çka po bëhet edhe pas raportit 6 mujor po besoj që rregullohet edhe kjo. Mirëpo tek e fundit ajo çka është e rëndësishme se janë të hyra komunale pasi diku ato po inkasohen edhe sigurisht se pak ka rëndësi se ka. Te shpenzimi i buxhetit besoj që këtë pyetje e shpjegova edhe më herët. Faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për sqarimin, po ashtu edhe unë pata pak hezitimin me kolegen Lushi, pasi kjo qenka participim nga qytetaret dhe komunës për rregullimin e rrugës. Gjithsesi faleminderit shumë drejtor për sqarimet. Atëherë nëse nuk ka dikush diçka tjetër, konstatojmë se kalon për Kuvend pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

### **3. Shqyrtimi i propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2018-2019 në vitin 2020.**

**Afrim Limani** – Përkundër asaj që ende nuk kemi marr një sinjal nga Ministria e Financave që me nis këtë proces për bartjen e të hyrave se është formë e rregullt, që vazhdimisht e marrim një sinjal që mundemi me qitë për Kuvend për bartjen e të hyrave, të them të drejtën në Ministrinë e Financave janë duke punuar me staf të reduktuar që jo çdo herë na kthejnë përgjigjen, atëherë që të mos vonohemi ne vet kemi marr këtë iniciativë pasi jemi të sigurt se ne si drejtori e Financave e dimë përafërsisht saktë shumën e mjeteve sa duhet me u bartë sepse e kemi bërë dorëzimin e pasqyrave financiare dhe në momentin kur dorëzohen pasqyrat financiare është gjithçka në rregull dhe nuk guxon të del asgjë jashtë kësaj vlere e bartjes së të hyrave. Ne do të marrim si vendim dhe në momentin që marrim sinjalin, ne e kemi materialin e gatshëm edhe munden me u alukua mjetet sepse në këtë proces jemi gati në fillim të majit edhe akoma nuk e kemi vendimin mbi bartjen e mjeteve. Shuma e mjeteve për bartje nga viti 2019-2020 është 232,766 euro, ku prej tyre 21,926 i kemi në paga dhe mëditje në kuadër të shëndetësisë ku vazhdimisht është një shume e mjeteve po bartet, pastaj në mallra dhe shërbime i kemi 850,000, kjo shumë është në kuadër të drejtorisë se Arsimit dhe pjesa për investime kapitale është prej 210,000 euro dhe këtë shumë ne kemi menduar në kuadër të disa drejtorive dhe disa projekteve kapitale, ku kryesisht kjo është bërë në bazë të një planifikimi të mirë edhe i kemi përzgjedh ato projekte të cilat vlera e kontratës ju ka skaduar edhe ka mbetur një pjesë e borgjeve për t'i mbuluar dhe për këtë arsye në vitin e kaluar në shtator të vitit 2019, në këto projekte nuk i kemi buxhetuar në buxhetin për investime kapitale mirëpo e kemi lanë që me pjesën e mjeteve të mbetura t'i ekzekutojmë dhe t'i shlyejmë këto projekte. Unë nuk dua tani t'i lexoj më shume tani sa janë mirëpo kemi projekte në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, drejtorisë së Urbanizmit dhe në Administratë. Po ashtu paraprakisht unë e kam edhe një kërkesë për ju Kryesues edhe para asambleistëve, që pas dorëzimit të këtij materiali, ka ardhë një kërkesë nga Drejtorja e Shëndetësisë konkretisht nga Drejtori që ka kërkuar që për Kuvend ta qesim edhe si pikë të re edhe si projekt të ri dhe kapital pra meremetimi i AMF-së në fshatin Malësi e Vogël sepse ai e paska mbledhur një ekip dhe kanë konstatuar se objekti është në një gjendje jashtëzakonisht të vështirë edhe duhet një meremetim urgjent, nëse e lejmë këtë deri në qershor atëherë kur kemi të drejtë me hapë një projekte të ri atëherë është shumë vonë dhe po ashtu edhe objekti dëmtohet më shumë. Nëse pajtohuni edhe ju që tash për Kuvend, unë e kisha qitë edhe një pikë të re edhe e kisha shtuar edhe një aneks për bartje, sigurisht ne e kemi menduar ku me i marr mjetet por esenca është me figurua si projekt kapital atëherë edhe me proces të rishikimit të buxhetit, ne mundemi me qitë mjete aty. Unë në konsultim me drejtorin kam menduar që të paktën një shumë simbolike prej 2,000 euro me nda, me rëndësi është me figuruar si kod në kuadër të investimeve kapitale. Këtë shumë ne mund ta marrim prej njërit prej projekteve po supozojmë pasi ende nuk jam përcaktuar, prej projektit Kompleksit të Dëshmoreve pasi i ka 53,000, pra mund të ja marrim 3000 euro edhe me qitë si projekt edhe esencialisht me figurua si projekt kapital dhe pastaj ne mundemi me i mbuluar edhe në faza tjera gjatë vitit fiskal me mjete buxhetore. Kërkoj falje për këtë që ka dal tani mirëpo ka dalë pas dorëzimit të materialit të KPF-së.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për sqarimin, në lidhje me kërkesën që e bën e cila ka ardh pas përfundimit të dorëzimit të materialit, unë jam pro kësaj por të shohim edhe asamblistët tjerë se çka vendosin.

**Rasim Fazliu** – Unë desha t'i drejtohem drejtorit me disa pyetje, është krejt në rregull që bartja e mjeteve duhet me ndodhë edhe të bëhet gjithsesi por ku do të shkojnë ato mjete atëherë kjo është një çështje që duhet drejtori gjegjësisht ekzekutivi bashkë me anëtarët e Kuvendit me vendos se ku është prioritare dhe ma mirë.

Edhe pse ne kemi një propozim konkret prej drejtorit të Financave. Çdo punë që kryhet nuk mund të themi se është keq pasi është e nevojshme të kryhen ato mjete dhe ky më mirë e dinë ku ka borgje apo obligime që duhet me shkua në atë drejtim por p.sh. do të ndalem te Ndërtimi i rrugëve si Xërxe, Celinë, Nashpall, Senoc etj kodit 43471 që janë 35,970 euro. Unë desha me ditë konkretisht te Ndërtimi i rrugëve pasi kemi diskutuar gjithmonë për këto gjëra pra kode të përgjithshme edhe jo të qarta pasi vetëm me emërtua diçka edhe nuk dihet konkretisht në fakt se çka bëhet, pasi është një shumë mjaft e vogël kjo dhe sikur t'i përfshinte të gjitha këto fshatra atëherë i bie një shumë e vogël të ju shpërndahen për të gjitha këto vendbanime andaj edhe dua të di se çka nënkupton kjo ndërtimi i rrugëve se cilat janë ato rrugë, a janë rrugë fushore apo që janë nëpër fshat që ekzistojnë pra çka nënkupton ky kod edhe a keni konkretisht diçka që me dhanë sqarime rreth kësaj, e jo të mbetet kështu si emërtim kështu si është e përgjithshme por normalisht që njëherë me na dhanë sqarimet pasi kështu si emërtim nuk është i keq por vetëm dua të dimë se çka do të bëhet. Pastaj do të ndalem te pagesat që do të bëhen pasi kemi raste ku komuna ka obligime konkretisht ndaj kategorisë së pensionereve atëherë pse p.sh. këtu nuk keni paraparë që të ju paguhen atyre njerëzve këto obligime pasi është marrëveshja me ju pagua, mos e merrni personale askush mirëpo po flas në parim, pra pse nuk e keni paraparë këtu që me atë bartje të mjeteve të parashohim që edhe një shumë të shkon te ajo kategori. Pastaj ndërtimi i kompleksit i varrezave të dëshmoreve, edhe këtu desha konkretisht se çka në fakt apo cili kompleks, pasi në komunë të Rahovecit kemi shumë si në qytet ashtu edhe nëpër fshatra, ku mendohet me u investua saktësisht me na dhanë sqarime sepse unë dua të përmendi konkretisht të nderuar të pranishëm që çuditërisht nëpër të gjitha qeveritë komunale që kanë kaluar deri tash, ka shumë investime të vogla sidomos për objekte shoqërore pasi fshati Celinë absolutisht nuk ka asnjë objekt shoqëror, vazhdimisht dëgjojmë si AMF-ja. QMF-ja, çerdhja e fëmijëve etj. pra nëpër të gjitha fshatrat ka diçka kurse në Celinë nuk ka asgjë. Nuk po dua të jem lokalist pasi mendoj se edhe aty ka banorë sikur në të gjitha vendet tjera dhe është shumë nevojshme pra është edhe interesante që asnjë objekt publik nuk është në fshatin Celinë, pasi shkollën e ka ndërtuar Caritasi gjerman, varrezat i ka ndërtuar me vetëfinancim nga fshati, kanalizimi është financuar nga vet fshati. Po ashtu e kemi edhe një sallë që ne e quajmë si shtëpi të kulturës pasi është afër shkollës aty, që mbi 15 vite që unë mendoj që ajo sallë nuk i donë as 10,000 euro për me qenë funksionale dhe që kish me krye punë edhe për nxënësit e shkollës edhe për nevojat e fshatit për shumë aktivitete të tjera, pra është një investim kaq i vogël kurse nëpër fshatra tjera ka vazhdimisht investime, nuk them që jam kundra që po investohet nëpër fshatra tjera por pse qeveritë komunale nuk parashohin në këtë fshat hiq kurrjë. Pra kisha kërkuar që nga këto mjete të mbetura me nda konkretisht diçka, po ashtu edhe varrezat që i kemi ndërtuar që janë në shkatërrim e sipër dhe asgjë nuk është bërë rreth kësaj që të intervenohet me një shumë, sigurisht që edhe në të ardhmen me nda edhe mjete tjera për t'i kryer ato. Po ashtu edhe për sallën që kemi në oborr të shkollës, kërkoj urgjentisht që në këto dy projekte të intervenohet dhe të bëhet diçka në këtë drejtim dhe të iniciohet dhe të ecim pak përpara. Faleminderit shumë!

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, edhe unë pajtohem që edhe kjo pjesa e buxhetit që ka mbetur nga viti 2018/2019 me kalua edhe me u shfrytëzua për vitin 2020, po e shohim se në kërkesën e drejtorit janë vendos disa kategori ekonomike ku mendohet me u shfrytëzua kjo shumë gjithsej 232,776 euro. Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, në shëndetësi është shuma është 21,926 euro dhe mua po me intereson se për çka do shfrytëzohet konkretisht kjo shumë, pasi drejtori i shëndetësisë po besoj që ai ka kërkuar këtë shumë dhe po e them se kategoria për paga dhe mëditje është kategori fikse dhe unë mendoj se kur është bërë planifikimi është bërë aq sa ka pasur nevojë, nëse ka diçka shtesë kisha dashur me ditë sot ose nëse ska përgjigje drejtori i financave atëherë ndoshta ka përgjigje drejtori i shëndetësisë për mbledhjen e ardhshme në Kuvend.

Kategoria për mallra dhe shërbime shuma e ndarë 850,000 euro për arsim, mendoj se është e arsyeshme pasi arsimit ka nevojë për shpenzime në këtë fushë dhe nuk është ndonjë shumë e madhe. Pastaj tek kategoria për investime kapitale në programin shërbime publike ceket aty ndërtimi i rrugës Ratkoc-Baboc shuma 16,106 euro. Sa kam dëgjuar unë se kjo rrugë është kryer pra është e asfaltuar dhe ndoshta drejtori ka diçka me na sqaruar, megjithëse unë kam parë se ky kod, ne i kemi të planifikuar në kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2019 janë shpenzuar 30.000 euro ka qenë planifikimi kurse për vitin 2020 kanë qenë të planifikuara 20,000 euro, kurse tani po ndahen edhe 16,106 euro, tani dua të di se a është kjo shuma shtesë apo hyn në kuadër të atij 20,000 euro që është planifikuar. Po ashtu në programin për planifikimin urban dhe mjedis,

Kompleksi i dëshmoreve kodi 40848, sa e pash unë është fjala për kompleksin në Gradish. Në kornizën afatmesme buxhetore ne kemi paraparë, për vitin 2019 që ka shkuar janë shpenzuar 20 000 kurse për vitin 2020 planifikimi ka qenë 10 000 euro edhe 2021 po ashtu 10 000 euro edhe me këtë unë e kam kuptuar se kjo po kryhet. Pra në kornizën afatmesme buxhetore është planifikimi është 10 000 me u shpenzua për këtë kompleks kurse ju po kërkonti tani 53 500 euro, a është e nevojshme ky investim me hyje nëse është ai kompleks aty. Ndërtesa për banim social kodi 40 844 gjithashtu kërkohet shume prej 60 000 euro nga ne me i aprovua ndërsa në kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2020 është paraparë 60 000, a është e njëjta shumë apo po kërkonti plus 65 000 euro, po ashtu për vitin 2021 është thënë se planifikimi ka qenë zero, pra është menduar që me këtë vite kjo ndërtesë e banimit social edhe me u krye, qe gjithashtu edhe unë them se duhet të kryhet sepse ka filluar që shume vite edhe është bërë investim kolosal në këtë banesë sociale nëse është kjo në Rahovec tek KRI-ja. Edhe kjo në fund, vendosja e ashensorëve që është kërkuar mendoj që është e arsyeshme, në delegatet e Kuvendit kemi kërkuar se ky objekte duhet ta ketë ashensorin por pyetja është se a mjaftojnë këto 2226 euro që të kryhet ashensori apo ndoshta është me arsyeshme me i marr prej këtyre kapitaleve edhe me i futë këtu edhe mu krye, pra është mirë që kur të fillohet një punë edhe me u krye, ashensori duhet të kryhet brenda një viti e jo sikur shkollat dhe ambulancat që me zgjat shumë vjet. Sa i përket kërkesës që paraqiti drejtori të drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, nëse është e nevojshme se kam dëgjua se ajo ambulancë ka probleme me drenazh dhe nëse është ashtu, unë jam që të ndahet por drejtori duhet ta paraqes saktësisht atë kërkesë edhe me ditë se nga cila pjesë do të kërkohet në mbledhjen e ardhshme me u ndaje. Pajtohem gjithashtu edhe me parafolësin Rasim Fazliu, që këto probleme që kanë pensionet, pagesat e tri pagave pastaj ato jubilarë pra e di që ka probleme qeveria lokale, mendoj se aty duhet të shikohet që të punohet në mënyre që mësuesit, arsimtarët që të mos shkojnë përmes gjykatës me krye atë punë sepse pastaj edhe komunës po i kushton edhe me shume shpenzimet shtesë por le të kryhet në mënyre procedurale siç është me ligje, nëse ka pare shtesë nga të hyrat vetanake pse të mos planifikohet ajo pjesë që të kryhet ashtu siç duhet. Faleminderit

**Afrim Limani** – Në fillim e thashë se krejt kjo shumë e mjeteve në vlerë prej investimeve kapitale 210,000 , është pikërisht për ato projekte të cilave ju ka skaduar kontrata pra është ndërprere kontrata dhe ne si komunë ju kemi mbet borxh, këtë e kemi pasur të definuar qysh para shtatorit të vitit 2019. Edhe në bazë të një analize që e kemi bërë ne si drejtori e Financave, përafërsisht kemi mundur me paragjykua se sa mundet me qenë bartja e të hyrave atëherë këto projekte nuk i kemi buxhetue, në mënyre që këtë pjesë të projekteve të i mbulojmë me këtë pjesën e bartjes së të hyrave pra e kemi kursye buxhetin andej, nuk e kemi buxhetue dhe e kemi lanë që me i krye përmes bartjes së të hyrave, pra krejt këto projekte janë të cilat ju ka skadue kontrata edhe ne si komunë ju kemi ngelë borxh, do të thotë a krye projekti dhe kjo pjesë tjetër është borxh. Ka projekte të cilat me emërtime të njëjta kanë lidhë kontratë të re, ajo është një kontratë e re dhe më në detaje rreth kësaj mundet të ju thotë secili drejtor pra kjo është pjesa e mbulimit të buxhetit pikërisht për këto projekte. Doktorit pyeti për pagat dhe mëditjet në shëndetësi pse, kjo vazhdimisht na është përcjell nga viti në vite pra kjo shume është përcjellur nga viti 2018 mirëpo në vitin 2018 nuk e kemi mbuluar nga pjesa e të hyrave vetanake pasi këtë pjesë e kemi mbuluar pagesat e mëditjeve edhe punën shtesë që bëhen në shëndetësi e kemi paguar nga pozicioni i rregullt pra nga buxheti qendror. Kështu që ne i kemi kursye këto mjete mirëpo sipas ligjit deri sa gjate vitit fiskal nuk i kemi bartë këtë shumë atëherë me bartjen e të hyrave obligohemi ligjërisht që me e mbuluar këtë pjesë të hyrave, njëjtë është edhe për mallra dhe shërbime në shëndetësi duke ditur se këto dy drejtori kanë edhe grandin e vet specifik. Po ashtu edhe një pyetje tjetër me rëndësi që bash kam kënaqësi me dhanë përgjigje, tek pagesa e mjeteve për pensione zakonisht e arsimtareve dhe stafit civil. Para se të priset situata nga pandemia e Corona virusit, komisioni për buxhete që mblidhet në qeveri ka kërkuar informata të sakta se sa është numri i stafit të cilët kanë dalë në pension deri me tash edhe nuk janë paguar edhe sa do të dalin brenda këtij viti fiskal sepse ky tani u bë edhe problem kombëtar e mos te them edhe ndërkombëtar, te njëjtat probleme i kanë secila komunë në Republikën e Kosovës edhe duke ditur kështu atëherë Ministria gjegjësisht Qeveria dhe unë vet kam pasur takim sepse në kuadër të planifikimit të buxhetit kanë dashtë me planifikua sakte që njëherë e përgjithmonë me zgjedhë këtë problem, edhe me i lehtësua procedurat e pagesës sepse edhe vitin e kaluar e kemi pasur një shumë konsiderueshme të mjeteve dhe kemi dërguar letrat në Ministri mirëpo nuk na kanë ekzekutua, pasi janë disa procedura dhe kode

të cilat deri atëherë nuk e kanë zgjedhë këtë problem edhe besoj që nëse stabilizohet situata ,po besoj që edhe ky problem do të rregullohet.

**Fehmi Cena** – Rreth atyre që pyeta me herët disa gjëra u sqaruan edhe disa nuk i kam të qarta, pasi pyetja ime ishte kështu p.sh. për ndërtesën për banim social është planifikuar sivjet me u pagua 65,000 euro në planifikim në kornizën afatmesme buxhetore mirëpo tash ju dëshironi t'i ndani 60,000 pra a është ajo shumë që keni planifikuar apo tani doni me i dhanë plus këtë shumë dhe i bie 125,000, nëse është kështu atëherë po kryhet, apo p.sh. kompleksi i dëshmorëve në Gradish, nëse është thënë se duhet të jepen gjithsej 50,000 euro edhe në vitin 2021 shuma komplete, apo kryhet me këtë shumë 53,000 euro apo është plus kjo, pra këtu është sqarimi im, përndryshe përsëri po kthehem tek çështja për pensionerët. Me sa e di unë është obligim i komunave me ju përgjigj punëtorëve të vet nga buxheti vet duhet të paguhet kjo. Nëse është ashtu atëherë kur keni buxhet shtesë, është përgjegjësia juaj dhe e drejta juaj, ne përkundrazi po ju përkrahim që ju me planifikua që mos me pas probleme as ju por mbi të gjitha qytetaret tanë, mësuesit tanë me gjykatën pra pse me pas problem me gjykatën. Pra këto janë të hyra vetanake që keni të drejtë me i shfrytëzua edhe për ato punë. Sa i përket situatës që nëse rehatohet siç po thoni, ju kisha thënë që na leni neve mjekëve me u marr me këtë punë e ju merruni me buxhet edhe s'ka me pas problem.

**Afrim Limani** – Doktor e thash edhe në fillim se shuma prej 210,000 euro është kryesisht për ato projekte të cilat kanë përfunduar dhe u mbyll kontrata edhe ne kemi mbete borxh për ato projekte. Pra e thash edhe në fillim se ka projekte që është i njëjti mirëpo vazhdon me kontratë të re dhe për këto mundeni me pyet drejtorin e drejtorisë përkatëse që i ka informatat p.sh. një shembull mundet me na dhanë drejtori i shërbimeve që e kemi këtu. Këto mjete janë kryesisht për ato kontrata të cilat janë mbyll edhe ne si komunë i kemi ngelur borxh për ato vlera që në total qysh i kemi të shkruara vlerat edhe aq i kemi mbete borxh. Unë pajtohem me ty që i njëjti projekt vazhdon prapë mirëpo është kontratë e re pasi kontrata e vjetër ka skaduar, pasi sipas ligjit të prokurimit një kontratë nuk guxon me tepër se tre vite me qenë, kështu që ato janë kontrata të reja. Kurse te çështja e pensioneve për këta që dalin në pension, e thash edhe në fillim se Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë mbajtur një takim dhe kanë kërkuar nga ne që me ju dërgua informatat e sakta se sa ka qenë numri dhe sa është tani, në mënyrë që ata me ligje të veçantë me alokue buxhet në kuadër tonin edhe procedurat ne duhet me i krye me këtë buxhet shtesë, në mënyrë që njëherë e përgjithmonë me eliminua këtë defekt që shumë vite po na paraqitet.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë drejtor i nderuar për sqarimin, atëherë nëse nuk ka dikush diçka rreth kësaj pike, pjesën që e bëri kërkesë drejtori për AMF-në në Malësi të Vogël a pajtoheni që edhe ajo të jetë si pikë shtesë për mbledhje të Kuvendit. Atëherë konstatojmë se kalon për Kuvend edhe pika e tretë e rendit të ditës me plotësimin edhe të kërkesës se drejtorit që kishte. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

#### **4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave juridik P-02279/0,02280/0 dhe 02281/0.**

**Përparim Krasniqi** – Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, më konkretisht do të ju jap në detaje, çështja është për deponimin e mbetjeve inerte që e kemi caktuar me vendim Kuvendi i Komunës, pra ideja është që me hedhë në ankand publik për një periudhë që e përcaktoni ju në Kuvend, që me marr në menaxhim një kompani e specializuar që të bëhet rregullimi i asaj, mirëmbajtja, deponohet me kujdes që mos të ketë degradim i asaj deponie. Krejt kjo ideja është që edhe ne planin e menaxhimit të mbeturinave që e kemi në kuadër të Komunës që kjo të zyrtarizohet me një kompani të specializune dhe të rregullohet ai vend aty dhe mos degradohet ai vende që është aty. Këto janë pjesë e parcelave të Komunës që janë 3 parcela mirëpo pjesa që do të jepet në ankande, ka mundësi që do të përcaktohet në bazë të vendimeve që përcaktoni ju, në të triat ose një pjesë të përcaktune apo qysh ta vlerësoni ju në bazë të vendimit që do ta marrim. Përveç kësaj në kuvendin e Komunës do të merret edhe një vendim për një taksë që do të deponohen mbeturinat e ngurta aty d.m.th. do të merret vendimi këtu edhe çdo hedhje e mbeturinave në kuadër të Drejtorisë së Ekonomisë dhe do të taksohet prej operatorit ekonomik që e menaxhon atë edhe do të ngarkohet me një gjobë të vogël, për shkak se do të kujdeset për punësimin aty, rrethojat dhe mirëmbajtjen e atij vendi edhe me një periudhë të caktuar prej 5 viteve do të jepet rekomandim pjesët jo mbushëse aty të bëhet gjelbërimi, qe do

të rekomandohet prej drejtorisë së shërbimeve publike se çfarë sipërfaqe do të behet aty pas mbushjes së asaj gropës. Kaq për fillim, nëse keni diçka të paqarte, unë do të jem këtu.

**Rasim Fazliu** – Unë fillimisht deshta të them, pasi nuk jam jurist por dua të i pyes juristët këtu që janë prezentë edhe në këtë rast edhe nënkryetarin. Këtu po thotë që kryetari i Komunës propozon Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave juridik, e thash edhe me e herët se nuk jam juristë ,por kjo fjala paraprak, po dua të di se a ka nevojë me ekzistua aty pasi nuk e di ne a kemi vendim paraprak për këtë çështje, unë mendoj se mundet me qenë si propozim vendim që kisha me thënë se është e drejtë me qenë kurse miratimin e vendimit paraprak, unë edhe njëherë e potencoj se nuk guxoj shume në këtë drejtim me ngul këmbë por në rregull atëherë siç e thuani ju. Sa i përket kësaj, drejtori na dha sqarimet e duhura rreth kësaj pike, unë mendoj se është e mirë dhe e qëlluar sepse ne veç e kemi lanë atë vend aty për hedhjen e mbeturinave inerte dhe është mirë ata, me marr përmes ankandit publik një kompani serioze e cila vërtet e bën menaxhimin e mirë, sistemimin e mbeturinave. Për momentin drejtor deshta me te pyet, njerëzit që e prishin një shtëpi apo diçka tjetër dhe nëse i dërgojnë atje ,a duhet me pagua për momentin apo siç qëndron kjo, pra ne momentin kur të zyrtarizohet çdo kush që hedhë aty duhet me bo pagesën. Pra atëherë jemi për këtë që të kaloj në Kuvend dhe është mirë me ndodhë kjo, që me marr dikush në menaxhim. Faleminderit

**Fehmi Cena** – Qe ta kemi me të qartë, pyetja ime është se a është fjala për deponinë që ne e kemi aprovuar para dy viteve këtu në rrethinë të Rahovecit, pasi është edhe ajo deponia inerte mbi rrasat atje rrugës për Prishtinë, që veçse kanë filluar disa biznese me funksionuar por tash është kjo tjetra dhe nëse është ajo që po thotë drejtori atëherë gjithçka në rregull me mirëmbajtjen e asaj pjese mirëpo unë e kam një brengë tash, nëse dikush e merr në menaxhim këtë pjesë edhe hudhja e mbeturinave inerte do të lejohet por në mënyrë të kontrolluar kuptohet edhe do të bëhet pagesa, por në anën tjetër ne e dimë se qytetaret tanë ka edhe të papërgjegjshëm që janë edhe mbeturinat i hedhin vend e pa vend edhe pse sot është deponia aty, pra i hedhin në vende jo të lejuara si skaj lumit, arës, vreshtave, skaj rrugëve tona kështu që ndoshta nëse bëhet me pagesë do të kemi edhe më shumë hudhje ilegale nëpër rrugë e rrugica dhe atëherë do të del pak më shumë për inspektoratin dhe komunën që punojnë në atë drejtim, që të bëhet me rrethua atë dhe me ja dhanë një karakteristikë sikur tash që po kërkohet me u rrethua edhe me u mirëmbajt. A do ta luan atë rolin pozitiv për të gjitha mbeturinat dhe për gjithë qytetaret që unë e paraqita brengën. Faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit z.Cena, atëherë meqë nuk ka tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon për Kuvend pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

#### 5. Të ndryshme.

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, a ka dikush diçka rreth kësaj pike, nëse jo atëherë mua me ka ardh një kërkesë në lidhje me një Informatë mbi mbikëqyrjen e zbatimit e planit të veprimit kundër korrupsionit për vitin 2018-2021 që ta kemi në Kuvend si pikë. Kjo ka ardh prej Ministrisë dhe duhet ta kemi si pikë e rendit të ditës. Unë kam biseduar edhe me Agronin dhe aty shkruan decidivisht jo bash në fund të muajit, që edhe me afat të pacaktuar për shkak të situatës që kemi të krijuar por nëse ka diçka që me urgjencë apo me afat të caktuar, unë do të ju kontaktojë secilit, pasi edhe vet ende nuk kam filluar me krye atë, për shkak se njëherë po dua të ju informoj rreth afatit të përcaktuar. Atëherë nëse nuk kemi diçka tjetër, gjithsesi për mbledhje të Kuvendit që po planifikojmë me datën 30 të këtij muaji, që unë po mendoj që ta mbajmë në Shtëpinë Kulturës për shkak që jemi në numër më të madh pasi që jemi edhe në situatë të jashtëzakonshme edhe pse nuk e kemi të shpallur kështu zyrtarisht e jashtëzakonshme do ta mbajmë. Faleminderit shumë të gjithëve për kontributin dhe shihemi në mbledhje të Kuvendit.

**Mbledhja përfundoj 11:30**

Procesmbajtësi,

  
Agim Hoti

